

## PARATHËNIE

“Çdo kush e di, si duhet edukuar fëmija i huaj”  
(Anonime)

*Lexues të nderuar,*

Fëmijët e shek. 21-te jetojnë në kohën e shpërthimit teknologjik në përhapjen e informacionit. Ne trendin aktual të zhvillimit të botës së sotme, të gjitha njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme jetësore nuk mund të jepen vetëm nëpërmjet (para)shkollimit. Informacioni i drejtpërdrejtë që jemi në gjendje t’u mësojmë fëmijëve tanë është vetëm një artikull i përmbajtjes që u nevojitet ta dinë në jetë. Kështu fëmijëve u mbetet për detyrë, domosdoshmëria për (vet)arsimim gjatë tërë jetës, madje nëpërmjet mendimit kritik! Ata duhet ta programojnë vet mendimin, përkatësisht ta ndërtojnë vetë sistemin e tyre të lojës dhe të nxënies.

Kam mendimin se **figurat** (fotot, pamjet) e **bollshme, te bukura e të rralla** për mesin tonë, në cilësinë e mjeteve shprehëse janë **tërheqëse, çlodhëse, interesante, funksionale dhe me vlera formuese. Figura gjithnjë duhet të thotë diçka!** Ajo flet gjuhën e saj dhe “përkthimi” nismëtar i mbetet mësueses. **Një foto e përzgjedhur dhe e bukur flet më shumë se “historia” e përmbajtjes matematike!**

Figura të mëson në mënyrë intuitive për të “zbuluar” dhe emërtuar: sende e objekte; pikësime e vijëzime; forma e ngjyra; emra e koncepte; simbole e numra; vizatime e modelime; rregulla e ligjëtori; zgjidhje e rrugëzgjdhje; ndërtime e rindërtime; sasi e madhësi; kohe e hapësirë ...

Nëpërmjet figurave zënë fill dhe zhvillohen **operacionet mendore: krahasimi, analiza, identifikimi, diferencimi, abstraktimi dhe përgjithësimi**. Madje, zënia fill dhe zhvillimi i aftësive më të rëndësishme intelektuale (**imagjinata, vëmendja, vështrimi, kujtesa, intuïta**) janë të lidhura me dhe për figurën. Figura ndihmon dhe mbështetë të **përfunduarit me analogji** (ngjashmëri)

Për librin parashkollor duhet të bëjmë shume kujdes, për të mos qene ai mall i lëndueshëm! Duke e pasur këtë ndjesi, i bëra të gjitha përpjekjet, për ta hapur një **“dritare dritëshumë për komunikim”** me fëmijë, nëpërmjet **figurave kolor**, te cilat **“flasim gjuhen e tyre, me shume ngrohtësi”!** Ato tek fëmijët ndezin emocione të fuqishme, të bukura e të gëzuara, kujtime mbresëlënëse, plotë me mallëngjim, deri në përqafim!

Në kërkim të fjalës së bukur u mundova të japë më të mirën time, lidhur me konceptet fillestare matematike. **Nga vetja e kërkoja të pamundurën; “të shpjegoja atë që nuk shpjegohet”; “ta shkruaja atë që nuk shkruhet”!** Për shkak të tematikës që ngërthen kursi, mora guximin dhe mundimin të përballem me përpilimin e dy vjershave mostër, për të cilat më ligjëroi zemra! **Duke u futur në “qenien e fëmijës” u përpoqa të “bëhem fëmijë” për aq kohë, derisa po shkruaja këtë dorëshkrim, për “mësuesit e fëmijëve”!**

Për punimin, modifikimin dhe restaurimin e figurave të librit, me cilësi të lartë e të rrallë profesionale, për punën e përkushtuar në cilësinë e redaktorit teknik, dëshiroj t’ia shpreh urimet dhe mirënjohjen time të thellë, profesorit të matematikës, z. Fitim Halili, mjeshtër i mbaruar i përdorimit të kompjuterit, duart e shkathëta të të cilit, e bënë autorin fatmirë, në përgatitjen e këtij libri deri në paus.

*Pas pensionimit, “mbase i fortë nga goja dhe nga lapsi”, pak besoja në “mandatin tim”! Si është e mundur, në “moshën e pleqërisë” t’i rikthehem “kohës së rinisë”, për ta shkruar “pengun e fëmijërisë”?! Në cilësinë e krijuesit ndjehem pikërisht si fëmijë shtatë vjeç, i lumtur, i plotësuar dhe shumë i realizuar! Më mirë se kaq nuk mundet!*

*Botimi i këtij libri më ka dhënë kënaqësi të madhe, për faktin që strukturimi i tij u kërkuar në vitin jubilar, të 100-të nga Pavarësia e Shqipërisë (1912). Kështu unë ngela me shume se i kënaqur!*

*Gjakove, 12.12.2012*